URDHËR
Nr. 334, datë 10.11.2020

PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PUBLIK TË ARSIMIT PARASHKOLLOR, KOPSHTI NË FSHATIN LOSNIK, NJËSIA ADMINISTRATIVE VELÇAN, BASHKIA POGRADEC

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të kreut I/A, të vendimit nr. 662, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike",

KONSTATOJ:

Këshilli Bashkiak Pogradec, me vendimin nr. 6, datë 28.1.2020, "Propozim për hapjen dhe funksionimin e institucionit arsimor publik, parashkollor, kopsht, në fshatin Losnik, Njësia Administrative Velçan", në zbatim të vendimit nr. 662, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, në bashkëpunim me Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Pogradec, pas konsultimit me përfaqësues të komunitetit të zonës, kanë paraqitur kërkesën e argumentuar, për hapjen e institucionit arsimor publik, parashkollor, kopshti në fshatin Losnik.

Bashkia Pogradec merr përsipër trajtimin me pagë të punonjësit arsimor parashkollor, sipas vendimit nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar", i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1, të nenit 41, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen e institucionit arsimor parauniversitar publik, të arsimit parashkollor, kopshti në fshatin Losnik, Njësia Administrative Velçan, Bashkia Pogradec.

2. Bashkia Pogradec të sigurojë ambientet dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së kopshtit, në bazë të legjislacionit në fuqi.

3. Bashkia Pogradec të realizojë procedurat për emërimin e stafit të kopshtit, bazuar në normat e punës mësimore, të përcaktuar në udhëzimin nr. 30, datë 12.9.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar".

4. Kopshti duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentacionin themeltar në ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, regjistër të veçantë, statistika vjetore të numrit të fëmijëve dhe të mësuesve;

b) regjistra të përkohshëm, si: regjistra klase;

c) rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit.

5. Institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit do të hapet kopshti i fshatit Losnik, të monitorojë veprimtarinë mësimdhënëse të këtij institucioni arsimor parauniversitar publik, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe Bashkia Pogradec.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi